

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-2
L19

TASHKO
LAKO

KUR KENDOJNE GJELAT!



814-2
L19

TASHKO LAKO

KUR

KENDOJNE GJELAT!

Satirike) e nū? E vērtēta

Tlönuspi 5000 people. Townsize 10x100/35. Start: 2504-12
Editor: Erika Velt
Illustrator: Jutta e. Müller

SHTËPIA BOTËRESE "NAIM FRASHERI"

СИРИЈА САНДЖАК

КУР

КЕВОГИЈЕ

ІТАЛІЯ (І)

Тишина (тишина)

тишина

(тишина)

Redaktor: *Myftar Memia*

Piktor: *Eriko Veizi*

Tirazhi 5.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Drejtoria Qendrore Poligrafike

«ИЗДАВАНИЈА МАСЕНТОРИЈА» Тирана, 1974

ISMET LAMÇJA I DYQANIT

Ismet Lamçja nuk ishte burrë sidokudo. Ai nuk ishte si ca e ca, që mbajnë të tjerët në-për gojë. Këtë Ismeti e kishte inat. Ai ishte mësuar t'u dilte vetë-për zot haleve të tij dhe nuk i linte të tjerët të futnin hundët në çështjet që nuk u takonin. Shkurt, Ismeti ishte burrë-për kokën e burrit. E hiqte veten si të ditur dhe, për t'i dhënë rëndësi diturisë së tij, përsëriste shpeshherë: «Kam rënë tri herë nga gomari unë, kam hipur dy herë në gjeminë e Seliştës dhe kam shkuar me tren gjer atje ku s'ta pretemendja. Jam i bredhur unë. Edhe në lundrën e Petoshajt jam hedhur e nuk i thonë shaka, se atje lumi ka dy bojë njeriu thellësi.» Por këto shkuan e vanë. Kui mbahen mend të gjitha ato që kalon njeriu në jetën e tij? E vërteta ishte sei Ismetin e mbanin me sy të mirë dhe sytë e mirë dinë kë zgjedhin.

Një ditë e thirrën në qytet, në zyrat e ndërmarrjes dhe i thanë: Kemi menduar të të caktojmë shites në dyqanin e fshatit, veç duam të dimë më parë edhe mendimin tënd. C'thua, e bën dot?

Sytë e Ismet Lamçes lëshuan shkëndija dhe

zemra nisi t'i rrihte fort si motor diezel, kur punon me një piston më pak.

— Oj, e bëj, thatë. Si, ore, nuk e bëj? — nxitoi të thoshte, duke iu marrë pak goja. — E bëj sa i luaj penxhin. Pa dhe në e paça ca si zor, ja tek ju kam ju. Vini ju e më ndihmoni. Përse i kemi shokët, apolllo i gjithan tani.

Kështu Ismet Lamçja na u bë dyqanxhi dhe filloi ta shihte veten si të parë dhe ta dridhte si t'i donte qejfi.

— Në fshat — thoshte — nuk është si në qytet, që varavinga, sapo ikën njëri kontroll, teptis tjëtri. Të nga drejtoria dhe komiteti, po, kur të zë në frymën edhe ata të kontrollit punëtor, të del banaku në mes të dyqanit dhe cipa e kallajit, që i ke hedhur surratit, të bie si suvaja me gëlqerë të pashuar. E, të gjitha këto, se kur është prak e brenda i përtyp lukthi, po kur të ishpifin atë fletërrufënë dhe ta ngjisnin në mes të sheshit që ta marrin vesh i madh e i vogël, të bie rrufeja në çak-kë të kokës e ta merr bojën fare. Ja, kështu është në qytet, ndërsa këtu, në fshat, ndryshon fjala, se ndryshojnë edhe gjérat. Ndodh që edhe këtu të pikkojnë si grerëzat e t'i numërojnë gjynahet mu në mbledhjen e fshatit, por, po ditë ta dredhësh gjuhën, sic të dredh plaka byrekun, ia gjen anën fjalles dhe e myll shtegun. Pastaj... po e leve qerrin, ajo e pret këngën dhe, kure pret këngën qerrja, zë e këndon ti pastaj, se nuk ta prish njeri avazin as për çarçana dhe as për çarçane. Kështu mendonte Ismeti dhe na e rregulloi dyqanin mirë e bukur. E ndreqi gjithë mallin që morri dhe, si vari një tabelë orari në derë, u ul atje në qoshe, pas banakut dhe para arkës së lekëve

dhe zuri tē mendonte: «Prite tani kur tē dukén nē derë e, si tē vijnë drejt e tek unë, tē më thonë: «O Ismet, pa na jep dy kile oriz, veç tē jetë nga ai, i vendit ama, se éshëtë térë lyrë, i uruari. Po deshe, na pesho edhe nya dy kile shieqer edhe këtë nga ai i vendit, po pate, se ngjit shumë ai.» Kjo éshëtë Lëre pastaj kur tē vijë edhe Hekua. Kërbu-njur-kërbunjur, do tē hedhë këmbën nē prak tē derës e do tē thërrasë që atje tej: «Më ngeli plakapëpa kripë, o Ismet. Bëj zahmet e më pesho si ndona nya tri kile. Në tē do qejfi, shtermë nē këtë enë edhe ca vajguri». Dhe unë do tē peshoj si tyxharëti njëherë moti».

O, Ismeti fshiu mustaqet, që i rëndonin mbi buzë si furça me fije nejloni, dhe fliste me veten: «De, o Ismet, de. Na u bëre tyxhar e shkuar tyxhërit, përvallahnë. Grosist fare, thuaj. Këtu, nē dyqanin tim, do tē dërdhet leku rrëke. Dhe leku, siç e dinë edhe vetë, tē lidh e tē zgjidh. Dhe unë do tē lidh e do tē zgjidh si tē më dojë mideja e kë tē më dojë mideja».

Kështu nisën i tē shkonin ditët. Dhe një natë shëndreu, tek rrinte shtruar pranë zjarrit me faqoren e rakisë përpëra e me mezenë shtruar, ullinj, turshi, djathë e lhudhra e një copë bukë tē thekur, Ismeti zuri tē mendohej:

«More, më duket sikur ai qerrata kandar peshon ca si ters. S'është ndonjë gjë e madhe de, sikur ta nxjerr qillon me ca dërhem më pak. Populli është keq për tē shumtën e jo për tē paktën. Pastaj, si dy dërhem më pak, si dy dërhem më shumë, qillo po qillo i thonë. Dhe, meqë është kështu, më mirë tē hajë nga e pakta se sa tē hajë nga e shumita, se është edhe viti i kursimeve ky,

ore. Pastaj... specin s'është nevojë ta peshoj fare. Më mirë e hedh nëpër fishekë siç bënte usta Xoxi në vakt të tij dhe çdo gjë vete në kararin e saj. Kështu edhe umë s'marr mundimin ta peshoj, po edhe myshterinjtë e gjejnë gati, se i duhet shërbypër shpejt e shpejt njerëzisë, ore, që të na thonë plot gojën: «Shërbëtorë të popullit». Sa për kafenë dhë sheqerin, do bëj si do bëj dhë do ta shtroj, gunën. Aty poshtë banakut bën ca si freskët dhë kafenë e sheqerin është më mirë t'i blësh nën freskllëk se sa në të thatë ku rrezikohen të thahën e të digjen për një pikë ujë.»

Kështu Ismet Lamçja i rregulloi të gjitha, kandar e mall bashkë sipas qejfit të tij dhe si usta i vjetër që ishte, dërhemët i «këndonin» nëpër duar.

«Tregëtia» zuri t'i shkonte mbarë, më imbarë nga ç'kujtonte. Me lekët e arkës kishte filluar të blinte e të shiste për hesap të tij. Kësaj i thoshin tregëti. Dhe Ismeti e ndjeu veten tamam tregëtar.

Po në fshat kishte sy edhe gojë. Dhe, kur systë zunë të shikonin, gojët pastaj nuk pushonin.

— Ç'po ndodh kështu më këtë dyqanxinë tonë? — thoshin njerëzit, duke e ngritur zërin fort gjer atje ku duhej. — Sheqerin dhe kafenë po e blejmë të lagur. Edhe dërhemët sikur i anojnë ca nga vetja. Edhe rakinië e ble dhe e shet si i do qeffi. Le pastaj që po e bën një nga dhia e dy nga vija. Ka shkop mbi këtë «zot», apo nuk gjenden më vuzhdaga frashëri?

Po Ismeti nuk u vinte veshim më «gojëve të liga». Ai krekoj atje në «dyqanin e tij», duke qëndruar pas banakut dhe para arkës.

Po një ditë era u kthyte në stuhi dhe asaj nuk

mundi t'i bënte ballë asnjë «pritë». Okët ranë përdhe, u rrökullisën, morën të kërcurë e të çarë dhe atehere Ismeti e pa veten zbuluar. — Amán bre, — thoshte po për të mirë! bre; e kam pasur, për të mirë. Nga të paditurit e kam bre, nga padituria. Aqë dita e aqë bëralin. — Mirë! Sipas qytetit është një vjet që nuk ka qenë. — Sipas qytetit është një vjet që nuk ka qenë.



Dha e mori Ismet Lamçja ta hidher shtegun,
por i mbeti këmba në bilagacë dhesë mbeti raty, ya
rur në kapërcyell. Deshi t'i rregullonte të gjitha
me kandar, por i rregulluan kandarin. Ai që kishte
rënë tri herë nga gomari, që kishte hipur dy herë
në gjeminë e Selishtës dbe ishte hedhur në lundi
rën e Petoshajt, atje ku lumi kishte dy bojë njeriu
thellësi, kësaj radhe nuk po i merrte më lopata ujë.



KUR KENDOJNÉ GJELAT!

Në kooperativën tonë bujqësore u hap fjala se në seksionin e bujqësisë të rrerith thanë. «Vitini e kaluar në kooperativën bujqësore X, ndonëse është malore, morën njëzet e gjashëtë kile grurë për hektar dhe siguruan bukën në vend. Atje bujqësia mori rrugë të mbarë. Dhe, përderisa ata të kaluan planin në një vit me thatësirë, këtë vit do të ecin përpara me hapa më të sigurt».

— Fitoret që kemi arritur — tha agronomi i kooperativës — janë jashtëzakonisht të mëdha. Tani bujqësia edhe në kooperativën tonë po vihet mbi baza të shëndosha intensive. Në grurë kemi marrë...

— Ta lëmë mënjanë grurin. T'u hedhim një sy degëve të tjera që përbëjnë atë trung të madh, që quhet bujqësi — ndërhyri shefi i seksionit të bujqësisë.

— Grurin nuk mund ta lëmë kurrë mënjanë, sepse me të është lidhur problemi i drithit — nguli këmbë agronomi.

— Ato që dihen, dihen. Më mirë t'u futemi atyre që s'dihen. Agronomi ngre supet, Shefi vazhdon:

— Është e vërtetë se nga një lopë keni marrë më pak qumësht se sa merr Lezan Pisli nga një dhi?

— Mos na ngatërrro me Lezanin, — ndërhyr agronomi — ai ka dhi të tjera, që, siç thonë, bëjnë çudira. Lopët tona janë mistrece.

Shefi vazhdon ta futë sondën gjithnjë e më thellë.

— Po me mbarshtrimin e derrave si qëndron puna?

— Ama, shoku shef, edhe ju, — i përgjegjet agronomi — gjetët përfarë të pyesni! Ne derrat nuk i qasim në sinuar dhe ju kërkoni të na i futni në fshat.

— Si kështu? Në plan keni...

— Ohu! Ne këtu kemi lidhur besa-besën që këmbë derri nuk do të lëmë të futet në fshat dhe gjere tanë nuk jemi turpëruar.

— Ju dëmtojnë derrat e egër?

— Jo, këtu e kemi fjalën për derrat e butë, se ata të egrit bredhin nga të duan e nuk na pyessin fare. Kanë, si i thonë fjalës, kartabianka.

Fjala shpon fjalën si gozhda dhogën. Shefi pyet dhe agronomi e ka gati përgjegjen:

— Epo... Siç duket, jeni marrë me drithërat, por keni lënë pas dore sektorin e blegtorisë.


— Sigurimi i bukës është problem kryesor, apo jo? Këtë vit do ta përqëndrojmë punën kryesisht në sektorin e blegtorisë — tha agronomi.

— Po, por bukë kërkon qumësht, gjalpë, mish, vezë, fruta... — nënvízoi shefi. — Por pa harruar sektorin e bujqësisë, ë?

Dhe biseda kalon në një kapitull tjetër. Është fjala përmëtarinë, sepse aty kanë rreth pesë-
10

mijë e pesëqind rrënëjë pemë dhe shtatë hektar vreshta në prodhim.

— Ju ua dini vlerën ushqyese frutave — tha shefi. — Sigurisht dini edhe t'u bëni shërbimet e nevojshme, të merrni rendimente të larta dhe t'i trajtoni ato.



— Ashtu është — pohon agronomi; — I duam pemët, por e keqja është se nuk na duan ato. Na kanë marrë inat. Edhe ne nuk e dimë ç'kanë. E vërteta është se ato papandehur mblodhën sunbulat dhe nuk u qeshi buza.

— Po vreshtat?

— Vreshtat? — Agronomi tund jakën e xhaketës: — Pa, pa, pa!.. Nuk kemi parë më noprane se vreshtat. Abrashkat e djallit! Nuk na dhanë asnje kilogram rrush.

— Po pjergullat?

— Bereqaversen! Nuk na janë fare duarbosh.

— Planin e rrjetës së pulave e keni realizuar, kurse planin e vezëve jo. Pse? Për c'arësy? E keni gjetur shkakun?

Agronomi vë buzën në gaz dhë përgjegjet:

— Janë gjela, shoku shef, janë gjela shumica. Mirë do të qe të ishin pula, po fundja gjelat i duhen fshatit. Vërtet nuk na jepin vezë, por ata e justifikojnë veten me mish, e aq më tepër me këngë. Janë të papërtueshëm. Ata s'pushojnë së kënduari.

Prandaj në kooperativat fqinje thonë: «Sa buktur këndojnë gjelat tuaj» dhe ju jeni dehur nga rendimentet e larta në drithëra dhe nga kënga e gjelave...

The Modular B system consists of the following:
1. Modular B-1000 - The basic unit
2. Modular B-1000A - An add-on unit
3. Modular B-1000B - An add-on unit
4. Modular B-1000C - An add-on unit
5. Modular B-1000D - An add-on unit
6. Modular B-1000E - An add-on unit
7. Modular B-1000F - An add-on unit
8. Modular B-1000G - An add-on unit
9. Modular B-1000H - An add-on unit
10. Modular B-1000I - An add-on unit
11. Modular B-1000J - An add-on unit
12. Modular B-1000K - An add-on unit
13. Modular B-1000L - An add-on unit
14. Modular B-1000M - An add-on unit
15. Modular B-1000N - An add-on unit
16. Modular B-1000O - An add-on unit
17. Modular B-1000P - An add-on unit
18. Modular B-1000Q - An add-on unit
19. Modular B-1000R - An add-on unit
20. Modular B-1000S - An add-on unit
21. Modular B-1000T - An add-on unit
22. Modular B-1000U - An add-on unit
23. Modular B-1000V - An add-on unit
24. Modular B-1000W - An add-on unit
25. Modular B-1000X - An add-on unit
26. Modular B-1000Y - An add-on unit
27. Modular B-1000Z - An add-on unit

Bënte vapë. Vapë korriku. Dielli digjte; e përvëlonte si saç. Kjo cilitdo mund t'i ngrintë tensio-nin arterial, po Koços as që i bënte përshtypje. Ai nuk qëndronte kurrë në diell. I pëlgente të qëndronte gjithmonë, në hije. — Në hije? — thoshte, sa herë që e pyesnin pér këtë «rregull», të tij. — mund të bëhen shumë gjëra, pa u ndire pa pësuar asgjë. Në hije as nuk digjesh dhe as nuk përvëlohesh. Të qëndruarit vazhdimisht në hije ka vetëm një-rrezik, të ftohesh rëndë ose të marrësh ndonjë plevit, në të dy kra-hët, por edhe kjo është plotësisht e imënjanueshme, në qoftë se njeriu tregohet i kujdeshëm. — Ja, pikërisht këtë kishte ai në qendëri të vë-mendjes së tij, ndërsa po i afrohej zyrës së drejto-rit. Kur arriti në prak të derës; qëndroi një hop, trokiti lehtë, dhe, pasi çelii derën, dhe futi brenda kokën e tij, pak vezaken pyeti tërë drojtjet e jetës.

— Me leje, shoku drejtor?

Drejtori me mirësjellje e ftoi të futej brënda
dhe i tha: — Urdhëro, urdhëro! Ç'kemi?

Koços iu duk se pikërisht tani ishte çasti më i përshtatshëm.

— Shoku drejtor, — e filloi «ligjératën» e tij tërë politesë — kam një hall të madh. Më duhen nja dy-tri ditë leje, po...

Drejtori u shqetësua përnjëherësh tek e shihte vartësin e vet të fiste ashtu, me drojtje të madhe.

— Hall? Çfarë halli? — e pyeti. — A mund t'ju ndihmoj? Mos u druani! Ne duhet të gjendëmi për njëri-tjetrin në gjëzime dhe në halle. Ky është morali ynë. Flisni, ju lutem!

Koçoja nisi të ndrydhej në vetëvete, sepse nuk e priste një qëndrim të tillë nga ana e drejtorit të vet. Tani duhej gjendur forma, mënyra se si të shprehej dhe kjo nuk ishte e lehtë. Ai donte të thoshte diçka, të svaronte diçka, por gjithmonë si pas parimit: «Mishi të piqet dhe helli të mos digjet». Por kjo nuk ishte e lehtë, sepse, kështu siç e priti drejtori, ishte rrezik që, po t'ia thoshte bamp e menjëherë, të digjeshin mishi e helli bashkë.

— Po ja... — filloi të fiste zvarrë sikur ta nxirrte fjalën nga thellësia e ndonjë pusi — ashtu e kam një hall. — shoku drejtor, një hall, se, si i thonë fjalës, gjithsekujt ia di vetë shtëpia...

— E drejtë, e drejtë, — ngulte këmbë drejtori — por ne jemi njerëz në radhë të parë, jemi shokë puñe dhe detyrimet tona shoqërore janë të mëdha ndaj njëri-tjetrit. Hallet tuaja janë edhe hallet tona, shok i dashur. Flisni, flisni, çfarë hallesh keni? Çfarë nevojash keni? Ne do t'ju ndihmojmë.

Koçoja, me atë zërin e tij të hollë si të kanarinës, vazhdonte të fiste tërë mirësjellje.

— Jua thashë, shoku drejtor... Kam një hall

të madh dhe dua nja dy-tri ditë leje, se kështu e kam punën.

Drejtori heshti. U mendua një çast, i nguli vështrimin dhe ndryshoi menjëherë qëndrim, por pa ndryshuar tonin.

— Atëhere, mik i dashur, më vjen keq, por jam i detyruar t'jua refuzoj kërkesën. Kur nuk e dimë nevojën tuaj, kemi të drejtë të themi se leje për pesë para spec ne nuk mund të japim.

Koçoja nuk lëvizi asnje tipar të fytyrës.

— Nuk është fjala për pesë para spec, shoku drejtor, — cicëroi duke e vënë pak buzën në gaz që t'i jepte të kuptonte eprorit të vet se ai ishte gati të duronte gjithshka, vetëm të merrte ato tri ditë leje — por nejse... Unë kam hall, pa erdhë, po... meqë është fjala kështu, njëlloj është. Po lar gohem. Më falni për bezdinë...

Ky qëndrim i «prerë» i Koços e preku drejtorin. Si mund ta linte ai të largohej kështu vartësin e vet, pa mundur t'i vinte në ndihmë?

U ngrit, iu afrua, pastaj i hodhi dorën miqësisht mbi shpatulla dhe e pyeti sérishmi.

— Epo flisni atëhere, ju marrtë djalli, ju marrtë! Çfarë halli keni? Ne jemi gati t'ju ndihmojmë me ç'të na vijë përdore.

Koçoja mori zemër. «Po sikur t'ia them? — mendoi. Tani sikur e terezita, më duket», dhe tërë guxim vazhdoi cicërimin e vet.

— E di si është puna, shoku drejtor? Dua të thur pak gardhin e shtëpisë. Më ka zënë ogradia me ciliminjtë e mëhallës. Unë thur e ata shthur. Unë mbill e ata ha. Jam apo s'jam zot malli xhanëm?

Drejtori ei dëgjoi gjer në fund idhe búzëqeshi hidhur.

Të lësh punën pér të thururi oborrin? I Buktur e paske menduar Hall di madh qenka vërtet — i tha dhe në zérin e tij shprehej ndjenja e thellë e keqardhjes. — Turp, turp pér ju!

Koçoja nuk e prishi gjakun, nuk e dha veten, nuk lëvizi asnje muskul, të fytyrës dhe munduhej t'i jepte asaj pamjen bënnjë njeriu t'ë pafajshëm, megjithëse përbrenda po ziente si kázan me üjë të valë.

Kështu? — foli me zë si të mekur. — Mirë atëhëre. Si të dëshironi ju. Unë nga halli e kam. Dhe, si uli kokën në shénjë të një pendimi të thellë, i hoqi fjalët zvarrë: — Unë nga halli e kam, po ju nuk marratë hallin. S'ka gjë.

Këto i tha drejtorit, ndërsa me mendje të vet bluanë: «Mirë, mirë. Di unë si e rregulloj ndryshtë punë. Rregulloj unë një nga ato marifetet, që rregullojnë këtë botë dhe ti s'kë pér të marrë gjë vesh fare.»

Një dhomë në poliklinikë. Aty viziton mjeku X. Ai, siç duket, është i mërzitur, është i lodhur, ndaj dhe shtrin krahët, gogësin dhë, me zë si të mekur i drejtohet infermierës.

Tjetri. — Infermierja çel derën dhe pason urdhërin: — Infermierja çel derën dhe pason urdhërin: — Tjetri. — Në dhomë hyn «tjetri». Ka lidhur veshin me

një shall të trashë dhe nën vesh ka vënë një shtëlliungë të madhe leshi. Mjeku e vështron me kureshtje — Ç'ke kështu, more derdimen? — e pyet pa lëvizur fare nga vendi. — C'të dhemb?

«I sémuri» flet me gjysmë zëri, gati si më të qarë, gati si më të luturi:

— Aman, doktor, se vdiqa. Kam tërë natën e natës pa gjumë. Më can veshi e më merr trutë. More, i vura vaj, do ti, more, fërkova grykët, do ti, i vura edhe shtëlliungë leshi spërkatur me raki e spec të kuq, siç e shikon edhe vetë, megjithatë po më luan çacka e kokës. Më bëj derman, doktor, në ke perëndi, se të mbeta në derë. Vdiqa, mbarova...

Doktori i hedh një vështrim që nga koka e gjer te këmbët dhe flet me përtesë:

— E mora vesh, e mora, po... a të djegin grykët?

— Oj, më djegin, thotë. Më djegin sikur t'i kem ngukatur me spec të kuq.

— Të lotojnë sytë?

— Vu fare. Çurk më shkojnë lotët.

— Ke të teshtitura?

— Aq sa shkul një mëhallë të tërë.

— Po zjarrillék, ke?

— Furrë. Kaminë fare, thuaj. Furrë gëlqere e djegur me dru lisi.

Mjeku arrin në konkluzion dhe, duke vazhduar të gogësijë, i kthehet infermierës.

— Etqartëp Shkruaj — i thotë — «Status grimalis».

«I sémuri» ndrydhet përsëri në vetëvetë dhe flet me gjysmë zëri:

— Doktor... jam edher në punë...

Mjeku i përgjegjet pa i ngritur sytë.

— E kuptoj, e kuptoj, i dashur — dhe përsëri i flet infermieres: — Mbushi modularin B. Dhe, si kthehet përsëri nga «i sémuri», shton: — Duhet ta ruani shëndetin, i dashur. Duhet të tregohëni më i vëmendshëm ndaj faktorëve klimaterikë.

«I sémuri» e fut në xhep modularin B dhe e falënderon mjekun, i cili vazhdon të shtrijë krahët si i përgjumur, të gogësijë dhe të thërrasë:

— Tjetri.
Dhe infermierja, si zakonisht, del në derë dhe përsërit thirrjen:

— Tjetri.

III

Koçoja, pasi u shërua nga grykët, shkoi përtë dorëzuar raportin mjekësor në administratë, por u takua me drejtorin. Përsëri Koçoja filloi të cicerinte me zërin e tij si prej kanarine:

— Me leje, shoku drejtor?

— Urdhëro! — iu përgjegj ai.


— Unë isha shumë i sémurë, shoku drejtor, por nuk kisha me kë të dërgoja raportin. Këta të administratës nuk arësyetojnë...

— Drejtori e pa drejt e në bebe të syrit.

— E thure gardhin, ë? — e pyeti.

Koçoja, si njeri me përvojë që ishte, u hoq menjëherë si një njeri i fyter, që e kanë prëkur thëllë në sedër.

— Bah! Ç'thoni kështu, shoku drejtor? Utinë isha shumë i sémurë. Shpirti im i e di ç'kam hequr



dhe ju, ne vend qe te me qani hallin, vimi e me shponi. Nuk eshtë mirë kështu, shoku drejtor — si mundua te kalonte menjëherë ne kundërmësy-mje per ta neutralizuar.

Drejtori tundi kryet ne menyrë kuptimplotë. Ashtu vërtet. Tani gjithshka per mua eshtë

e qartë — tha. — Por kontrolli punëtor do t'jua bëjë edhe më të qartë në mbledhjen e kolektivit.

Koçoja u hodh përpjetë sikur ta kishte pickuar atë çast nepërka.

— Kontrolli punëtor? Mledhja e kolektivit? Mos, mëre, se më fikët!

— Hajde, hajde, — i tha drejtori — ti sapo u ndezi dhë, po nuk të fikëm ne, është rrezik të na përvëlohesh fare.

IV

Mbledhje në kolektivin mjekësor të poliklinikes.

— Ja kështu, shokë. Ne, mjekët, — flet mjeku X me pasion — duhet të tregohemi të kujdeshëm. Duhet të jemi, si të thuash, të ndërgjegjshëm në çdo veprim që kryejmë. Luftëri kundër liberalizmit dhe indiferentizmit duhet ta kemi në qendër të vëmen-djes të punës sonë, sepse është bëre zakon që një më dy/dhe fët; tri ditë pushim i japim tjetrit edhe pse i dhemb një cikëz llapa e veshit. E mbushim si të thuash, modularin B, pa pikë përgjegjësie. Nuk është mirë kështu, shokë. Nuk duhet të na vijë mirë, sepse në kësi rastesh përfitojnë njerëzit e pandërgjegjshëm në punë. Ja, kaq desha të thosha.

Mjeku X ulet. Është i entuziazmuar nga diskutimi i tij. Edhe kolegët e miratojnë atë diskutim të zjarritë. Dikush kérkon ta mbështetë, por nuk arrin të ngrihet në kohë. Është ngritur një punëtor. Ai flet në emër të kontrollit punëtor, në emër të kolektivit, të vet, që e bëri «usta». Koçon, për

Iemzë. Aí u drejtohet mjekut X dhe gjithë të tjerrëve;

— Bukur fole, o shoku doktor, — i thotë — po në ndërmarrjen tonë, kur shqyrtuam raportet mjekësore apo modularët B, siç i quani ju, që i lëshoni si pikat ~~ël~~ shiut, thamë kështu: «Jetë të gjata mjeikut X, se pa të nuk thuret gardhi i shtëpisë.»

Mjeku X coroditet. Kolegët i kërkojnë atij shpëgim e ai e sheh veten më ngushtë se sa kur kishit dhënë provimet e shtetit, por këtë radhë i shkonin djersë të ftohta.

o sifatde veitare p. m. Al Amrofot is eq. basie
- sepi. 1945. off. S. M. R. A. 1945. 1945. 1945.
- 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945.
- 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945.
- 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945. 1945.

Die anderen drei Mittelkinder
wurden ebenfalls von ihrem
Vater auf die Schule geschickt.

Von der Stadtkirche zu Lübeck aus ist die St. Petri Kirche nicht weit entfernt. Sie ist eine sehr alte Kirche, die im 13. Jahrhundert erbaut wurde. Die Kirche ist ein einschiffiger Saalbau mit einem hohen, spätgotischen Chor. Der Chor ist von einer steinernen Kanzel umgeben, die von einem Renaissance-Meister geschnitten wurde. Die Kirche hat eine reiche Innenausstattung, darunter ein wunderschönes Altarretabel aus dem 15. Jahrhundert und eine Reihe von Grabsteinen aus dem 16. und 17. Jahrhundert.

FEJESE PA LLOGARI

Lajmi u hap e mori dhenë siç hapet vaji në lakra: «Samiu u fejua me mësuëse Sanijen. Sot një javë bëjnë gostinë. Të na trashëgohen e më kokë të tjerëve!»

Fejesa po si fejesat. Ditën e gostisë shtëpia e mësuesë Sanies u tund nga këngët dhe vallet popullore. Këndonin të ftuarit. Këndonte edhe vetë çifti. Hyzmetçinjtë bënin çmos që tryesa të ishte plot e përplot. Rakia derdhej duman-duman, ndërsa kënga shpërndajahej:

Kokën ma mban lart,
syt' m'i mban mbërdhe,
folë, moj moll e kuqe
.....

Vonë, kur u ngritën edhe gotat e funditt dhe se cili shkoi në punë të vet, dy të fejuarit dolën përtë parë se si ndriste hëna dhe përtë numëruar sa yje kishte qielli. Atë natë gjithë bota ishte në pëllimbë të tyre dhe ata e ndjenin veten zotërit e saj.

Shkuan dy javë që nga ajo ditë dhe, gjatë kësaj kohe, ata e blenë dhe e stërblenë kaq herë njëri-tjetrin, dhe i bënë e i stërbënë llogaritë pa harruar gjer edhe shpërgënjtë e trashëgimtarit. Shkurt, gjatë këtyre dy javëve ata njoftën «karakteret» e një-

ri-tjetrit dhe javën e tretë secili mori «pozicionin» e caktuar.

Samiu, si burrë që ishte, filloi të jepte rekomanadime. Kjo, sipas tij, ishte një e drejtë ekskluzive e burrit. Ai gjithmonë duhej të rekomanandonte, ndërsa ajo tërë jetën duhej vetëm të zbatonte rekomanimet e tij. «Kështu është gatuar kjo botë, thoshte ai. Gruaja ka dalë nga brinja e burrit dhe më brinjë duhet të qëndrojë, që të ruajë brinjët e saj, se s'dihet, mendje është dhe, kur kapërcen mendja, dora nuk përbahet fare».

Në fillim Samiu e nisi ashtu urtë e butë, në formë këshillash që të mos linte përshtypjen e një patriarku, por të një njeriu me mendje të ndritur.

— Dëgjo këtu, Sanije! — i thoshte tërë «dëshamirësi». — Sot, tek isha andej nga rosticeria, të vura re se ishe me atë, me atë, moj, se nuk ia di mirë as emrin, Riti, Margariti, si i thonë...

— Margarit.

— Hë! Atij i njoh dhëmbë e dhëmballë unë.

Sanija donte të fliste, donte t'i thoshte se e kishte shok të fëmijnisë, po ai e ndërprenë:

— Vërë re këtu. Sakën se të shoh të këmbesh goftë edhe një vështrim me të. Larg, sa më shumë larg atij njeriu meskin!

Pas një javë ai iu shkreh tërë inat dhe nga sytë i dilnin xixa si maçokut në errësirë:

— Dëgjon? Me ty e kam. Ç'të lidh me atë Hilminë, ë?

— Asgjë. Ai është kujdestar i shkollës ku unë jap mësim.

— Qoftë me shëndet! Ai është i «rrezikshëm», E kupton zotrote se ç'domethënë i rrezikshëm? Ja ku ta them unë. Të rrezikshmit ta këndojnë kë-

ngën menjëherë dhe unë nuk kam nge pér avaze, më kupton?

— Ai éshëtë aq i sjellshëm — mundohej ajo të arësyetonte, por Samiu ia preu fjalën në mes.

— E sheh? Ke rënë në grackën e tij. Ti paska thartuar trutë. Ta paska bërë mendjen firifiu. Vëri gishtin kokës, Sanije, dhë mos e merr veten nëpër këmbë. O me mua, o më atë! Qartë?

Tërë atë javë ai i qëndroi hundë e bazuës së fejuarës, me gjithëse ajo bënte çmos ta qetësonte, ti krijonte atmosferë të ngrrohtë.

— Sami, porosita një palë këpucë pér ty.

— Fort mirë, veç mos të të shoh më të shëtisësh udhëve. Nuk dëgjohen fjalë të mira përrata që shëtisin.

Ajo bëri sikur nuk e dëgjoi dhe shtoi:

— A do të shkojmë nesër në teatër? Ai e vështroi vëngër dhe e kapérceu fjalën.

— Hë, se gati harrova — vazhdoi në avazin e vet. — Ajo Lena éshëtë femër e papërshtatshme. Mirë éshëtë të mos shogëróhesh me të.

Sanija nisi të mendohej thellë, nisi të bënte llogaritë.

Fshati po dukej dhe, s'donte kallauz. Mendja e Sámiut tregonte se ajo ishte në një skuadër me atë që prishtë gjithë variantin taktik duke dalë vazhdimisht ofsjat. Një ditë i shkroi një pusullë: «Sot bëra edhe një herë llogaritë përpara se të prishej tabela e logaritmave. Po të vazhdonim kështu, do të zbatohet proverbi: «Kur të vijnë mendtë, s'ti hanë as qentë» dhe unë s'kam aspak dëshirë të më trem me qentë.» Samiu e lexoi dhë e rilexoi shumë herë atë le-

Se o papa deixa o seu filho só em casa, é porque
o seu filho é um bom menino e não é mau.



tër dhe s'dihet se për të satën herë pëshpëriti: «E infektuara!»

Sekush eci në rrugën e tij... Të gjithë e morën vesh se ç'lakra kishte Sâmiu në kokë. Ai kokulur dhe i mbytur në djersë doli nga salla duke pëshpëritur: «Tani filluan të më vijnë mendtë, por tani...»

«HEROI» I SEKTORIT TONE

E shoh përditë. I veshur me xhaketë mëshini, me pantallona të gjëra, me flokët e pispilosur; ecën sa andej-këtej mëpër sektor tamam si fandi spathi, që del aty ku s'duhet dhe s'del atje ku duhet. **E** pyes:

— Përsëri kështu?

— Përsëri — përgjegjet dhe mbahet me të madh sikur të jetë vetë shahu i Persisë.

— Gier kur?

— Gjersa të merrni në konsideratë kërkesat e mia. Nuk jam njeri dosido unë. Jam me shkollë unë. Kam mbaruar shtatëvjeçaren natën, e kuption? Dhe me aq shkollë shemben edhe malet. I njoh mirë sektorët e punës unë dhe, në pyetsh hollë-hollë, sektorin e kulturës e njoh edhe më mirë se çdo sektor tjeter. Jam i prerë për punët e kulturës unë, Ju nuk më vlerësoni mua, aftësitë e mia...

— Shko në fushë si gjithë shokët — i them dhe
ëpëvështroj' me keqardhje. Me tërë ato shpatulla
sorollatesh kot së koti këtyre cepave.

— Eshtë punë për mua — ma pret me një të
rënë të sëpatës. — Ju lutem të mos i futni hundët
aty ku s-duhet, se ndryshe do të detyrohem t'ju
prës turqikat.

Ai largohet. Largoher edhe hija e tij. Vetëm ajo e ndjek pas me besnikeri dhe ai i thur e i ithur kurora lavdie vetëvetes, duke i rënë vazhdimisht fyellit në një vrimë.

— Më jepni punë të përshtatshme. Dua punë të përshtatshme. Më takon një punë e përshtatshme.

— Shko në fushë, puno, vil rrushë si shokët — i thonë.

Dhe ai, për t'u treguar të tjerëve se është i «lindur» për punë të rehatshme, shkoi në fushë, punoi dhe në një muaj bëri 12 ditë punë në një kohë kur shokët realizuan mbi 25 ditë punë kooperativiste.

Përsëri turfulloi.


— E shihni? Nuk jam unë për në fushë. Më jepni punë të përshtatshme. Punë në sektorin e kulturnës, desha të them. Ju nuk më përkrahni.

Ecën si gjithmonë, kapadai, si kaposhi majë plehut, si kalli pa bukë dhe si më i «dituri» që është, zë e kritikon më të djathtë e më të mëngjér. Ç'të bëjë? Po të rrish hijke e të mos u shtrohesh punëve, lakra në kokë do të prashitetësh dhe do të veshtrosh me dylbi edhe qimen në syrin e tjetrit, ndërsa trarin që ke nën hundën tënde as që e vë re. Kështu edhe ai. Ngaojë s'ka me se të merret, mërrret me «kritikë». Siç duket kërkon të diplomohet në fushën e kritikës dhe të bëhet kështu specialist kritizer.

Dhe, megjithëse ka edhe më keq, një e keqe u bë këtu e ca kohë më parë.

— Do të punosh si punëtor magazine, — i thamë — të pëlqen? Paga është me ditë fikse.

Bah! Unë punëtor magazine? Unë, kuadër me shkollë, mund të drejtoj shtëpinë e kulturnës, mund



Koq'as u hap'as Brenda 'hyri nje,
dhi. Ma placiñ sylé, ne ju gönjej! Brenda hyri nje
dhi a madhe, e critur, me gil tó frysé ngn qumish-
ti. Pas, si roje, i shkonin dy kocér. (Sig u mor vash
më vonë, ata ishin keçlirit u-saj, sepsa ajo më pas-

ta bëj edhe shef llogarie, bile, — shtoi ai — tjetër se nuk m'i çmoni aftësitë e më keni marrë me sy të keq. Për këtë do t'i shkruaj edhe qeverisë...

— Turp për ty! Përse sillesh rrugëve e kafe-neve e nuk vete në fushë përkrah shokëve, por ushqehesh parazit nga djersa e të tjerëve.

— Ai u përgjegj rreptë:

— E dinë të tjerët atë punë. Ka se kush i sheh këto gjëra. Ju shihni udhën tuaj.

Ja, ky është «heroï» im. Atë e njohin të gjithë, po më i njohur ai u bë pardje, në mensë, ku u ngrit duke turfulluar.

— More Andon! More kuzhinierziu! — thërriste me sa zë kishte. — Po gjellë është kjo, more? Ç'janë këto lakra që gatuan kështu, more? Pse, lopë jemi ne që na jep silazh, more? Kjo nuk të shijon fare-fare, more?

— A e di pse nuk të shijon, or babaixhan? — e pyetën ca të rinj që po hanin në tryezëm përbri.

— Se kuzhinieri s'di të gatuajë. — u përgjegj ai rëndë-rëndë.

— Nuk të shijon se nuk ke derdhur asnje pikë djersë, se ende sytë i ke të fryrë nga gjumi — i thonë ata.

Dhe ai u largua kokulur.

— Një gjë që më vlerësoj është që 'në këtij fjalë s'ka një përgjegjësi, nuk i është dhënd u illo i jashtë spikës së marrëveshjes së përgjegjësit. — Përveç kësaj, që do t'i bëj që qëndroj u po t'ill t'ekzistojë një shkolla e shëna që varet u shkollat e përgjegjës së përgjegjësit. — Shkolla që t'i bëj që qëndroj u po t'ill t'ekzistojë, që do t'i bëj që qëndroj u po t'ill t'ekzistojë. — TË FALA NGA DHITE E JEDSIT —

— Illo i marrëveshjet e përgjegjësit që qëndroj u po t'ill t'ekzistojë, që do t'i bëj që qëndroj u po t'ill t'ekzistojë. — Të fala nga dhite e jedsit —

— I shih mbledhur aty te stallat dhe fjalën e kishte marrë përgjegjësi i blegtorisë, një mesoburre, që thoshte se e njihte blegtorinë që kur kishte njo-hur veten. Ne sa ishim dëgjonim me vëmendje dhe e vështronim jo në beben e syrit, po në majën e gju-hës, nga e cila buronin mjaltë e sheqer. —

— Kështu, shokë, kështu, Lopa është fabrikë mishi dhe qumështi. Po, po, fabrikë qumështi po them... —

Dikush trökiti në derë. Përgjegjësit tonuk li erdhë mirë që e ndërprënë në kulmin e fjalimit të tij të zjarrtë, po, deshi, s'deshi, sundetyrua të tregot e njerëzishëm e të fliste me ton gurdhëruesh qashtu shkurt e qartë, siç e ka zakon kur u jepi gurdhë; të prerë brigadierëve. Që dhaunt qimlaq, ëntollit ët —

— Hyrë.

— Kanati i derës u hap dhe brenda hyri-një... dhi. Më plaqin sytë, në ju gënjej! Brenda hyri një dhi e madhe, e rritur, me gji të fryrë nga qumështi. Pas, si roje, i shkonin dy kecër. (Siç u mor vesh më vonë, ata ishim kecërit-e saj, sepse ajo na pas-

kësh qenë dyjare). 'Ajo qëndroi përpara përgjegjësit, i cili u hodh një hap prapa.

— Tyt, dreq! — thirri i çuditur. — Nga djallin na u fanepse këtu? Hë, këput qafën, shporru! — dhe, duke u kthyer nga një bari, urdhëroi: — Hiqeni këtej të paudhën! E kujt éshtë?

— Duhet të jetë jabankëshë. Dhii të tilla nuk na ka zënë syri më fshatin tonë — u përgjegj dikush.

Përgjegjësi e mblođhi mendien.

— Mjaft! — urdhëroi rreptë. — Nxirreni jashtë!

Dikush u afroa të zbatonte urdhërin, po dhia mori qëndrim kërcënues, u mbështet mirë e mirë në këmbët e pasme dhe blegerit;

— Meee... — Përgjegjësi u zu ngushtë. Ngjarje të tillë as kish te parë dhe as që kishte dëgjuar.

— Urdhëro e rri atëhere, — i tha — meqë s'dashke... — Përgjegjësi vazhdoi, duke e vështruar tërë çudi!

— Urdhëro e folë tan! Cila jë, nga vjeni e qfarë ere të solli këtu?

Dhia nuk u nxitua. I hënë urdhërit një vështrim sa illës, u kollit pak ashtu siç kolliten oratorët para se të fillojnë fjalimin, tundi një herë mjekrën, dhe foli:

— Unë jam Syska, më e dalluara dhe më e mira në tufën e kooperativës fqinje. — Si? — Si, si? — pyetën të gjithë njëzëri. — Sigur, sigur po ju them. Dhe kam ardhur këtu e dërr

guar nga gjithë motrat e mia. Ju kam sjelle një letër nga të gjitha ato.

— Një letër nga dhitë? Kjo hyn në shtatë çuditë e botës.

Dhia nxori një zarf të madh, e celi, mori letren dhe nisi të lexonte me zë të lartë:


«Të dashur shokë! Shumë i ndeuari përgjegjës! (Përgjegjësi e kishte humbur fare dhe vështronte i hutuar, fërkonte sytë për të parë në ishte në të dhënë a në zhgjendërr, por dhia vazhdonte leximin). — Ju shkruajmë ne, dhitë e kooperativës fqinje. Pasi u mblohdhëm sot me rastin e hartimit të bilancit të prodhimit tonë, ju njoftojmë me kënaqësi se detyrën që na kishin caktuar e plotësuam me ndër. Çdo njëra prej nesh prodhoi 125 litra qumëشت. Besojmë se edhe ju do të gëzoheni me fitoren tonë. Po ne me se do të gëzohemi për ju? Nga sa nái kanë thënë e nga sa kemi marrë vesh, ju mezi paskeni marrë tetëdhjetë litra nga një lopë. Po si do t'i thoni fshatit o të uruar? Së mos ua hidhni fajin lopëve?! Po vepruat kështu do t'ju vënë një fletërrufe që t'ju vijë festja vërdallë. Nuk jua kanë fajin lopët por kokë. Atyre, po u dhe, të jepin, po s'u dhe, s'ke ç'u kërkon. Po ju, more të bekuar, i keni lënë lopët hazat. C'prisni vathere nga ato?

Një dhi në mal dha më shumë qumëشت se një lopë, në stallë. Vérini gishtin kokës. Ja, kaq kishim për të thënë. Mbetshi me shëndet! Të fala nga tufa e dhive e kooperativës fqinje».

Kaq tha dhia dhe veshtroi përgjegjësin sikur të dante fi thoshtë: «Hë, folë! Rërgjegjul!»

Po ç'të përgjegjej përgjegjësi, kur vërtet nga

një lopë kishte marrë tetëdhjetë litra qumësht gjatë një viti? Të thoshte që janë lopë vendi? Mund edhe ta thoshte atë fjalë, por nuk ia mbante të mjerit, sepse dhitë ia thanë troq: «Edhe ne kemi një tufë lopësh vendi. I kemi atje në mal ku kullosim vëtë. Barinjtë u kujdesën për to dhe ato e dyfishuan prodhimin».



E si t'ia bëjë përgjegjësi?

Dhia u ngrit. Nga pas i shkuat kecat. Te dera ajo u ndal përsëri.

— Të na përgjegjen përgjegjësi e brigadierët, dëgjuat? — tha dhe e kapërceu prakun.

Atëhere përgjegjësi, pasi e mbloodi mendjen, e vazhdoi fjallimin. Atje ku e kishëtë nisur.

— ... Po, shokë. Lopa në kooperativat e tjera është fabrikë qumështi, por jo si këtu te ne. Kritika është e drejtë. Sivjet do të bëjmë çmos që t'i plotësojmë detyrat.

Shkuan kecat, i cili ka qenë përfundim i kësaj vende? Mbështetje shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende? Shtetërore shtetërore e kësaj vende? Përveç kësaj vende?

— Dreqi e mori edhe këtë punë! — thirri dhe atë çast u dha në derë njëri nga ndihmësit e tij më të afërt, që merrej me problemin e furnizimit.

— Cilin e mori dreqi? — pyeti. — O burra ta shpëtojmë!

Drejtori i hodhi një vështrim të shpejtë e pastaj tundi kryet në shenjë dëshpërimi.

— Nuk kemi ç'të shpëtojmë. Gjashtëmujori na la shëndenë dhe bashkë me të edhe perimet që nuk ia dhamë popullatës.

Dhe i shpjegoi ndihmësit të tij të parë se si qëndronte puna. Atëherë të dy, mbledhur kokë më kokë, zunë të mendoheshin për të gjetur «argumenta», se në mbledhje ato duhen. Pa to, e ke të humbur davanë.

Konkluzioni që arritën qe i qartë: «Kjo puna e furnizimit të tregut me perime është sëmundje e vjetër. Populli ka të drejtë ta ngrejë zérin dhe ta çojë atë gjer në kupë të qiellit. Po tjetër është të ngresh zérin dhe tjetër është të hash perime. Për

këtë komiteti ekzekutiv duhet të bindet se ne nuk e mbajmë të gjithë përgjegjësinë. Ajo duhet të rëndoje kryesish mbi prodhuesit. Na dhanë ata, japim ne. S'na dhañë ata, s'japim ne. Kështu janë të lidhura këto punë. Ja, janë shkruar këtu, në kontratë.»

Dhé... me kontratë e diskutim në dorë, drejtori shkoi në mbledhjen e komitetit, u ngrit dhe mbajti një ligjërati të zjarrtë, që nisi e bitisi kështu:

«Ne, shokë, e kuptojmë përgjegjësinë e rëndë që kemi. Për këtë jemi të ndërgjegjshém se nuk i kemi dhënë popullit sasinë e zarzavateve, nuk i kemi dhënë sasinë e nevojshme të vitaminave. Këtu, shokë, nuk ka asnje pengesë objektive. Po, po, kështu është. Të gjitha të këqijat kanë ardhur për shkaqe subjektive, kryesisht për mungesë organizimi. Po... ç'faj kemi ne kur furnizuesit tanë nuk e vunë dhe nuk duan ta vënë fare dorën në zemër? Qenkan zemërgurë, për besë, qenkan zemërgurë, po ju them, gurë stralli fare e në mos më keq.

Unë jua them sinqerisht, shokë. Sinqerisht, fare haptazi. Jemi keq. Nuk na vjen aspak mirë, po ç'të bëjmë? Ne kemi faj, po fajtorë më të mëdhenj janë ata të ndërmarrjes bujqësore.

Na besoni, shokë. Na ranë shojet e opingavë duke bërdhur poshtë e lart, po gjendja nuk po ndryshon, se nuk pyesin për shojet tona. Epo, fundja, shoje të tjera nuk kemi ku të gjejmë, se këtë këmbë kemi. Mos do t'uua marrim hua këmbët le-pujve, që të bërdhim lart e poshtë gjithë ditën?»

Kaq tha dhe u ul duke fshirë djersët me shamil. «Shpëtova, tha me vete. E hodha edhe këtë

hendek, më duket. E hodha dherua hoddhë. Kështu e kanë këto punë,» dhe fërkoi lehtë duart. — Po, pikërisht atë qastiu duk sikur ra brenda në hendek, ngaqë pyetjet rrrodhën njëra pas tjetrës. — Përse jeni mbajtur vetëm me sektorin e ndërmarrjes bujqësore dhe nuk keni kontraktuar edhe më kooperativat bujqësore, që janë afér qytetit — pyeti njëri prej anëtarëve të komitetit. — Nuk e din që koopérativave bujqësore po u shkoni në dëm perimet, kurse qytetarët disa lloje perimesh herë-herë nuk i gjejnë në treg?

— Përse fshiheni sot pas kësaj kontrate dhe nuk keni luftuar për ta zbatuar atë gjatë gjithë tremujorit? — e ngau më tej pyetjen një tjetër, siç duket i deleguar nga qendra. — Si është e mundur — shtoi ai — që nga rrëthi juaj furnizon me perime edhe rrëthet e tjera, ndërsa ju vetë nuk plotësoni kërkesat e konsumatorëve.

— Populli do perime e jo justifikime — tha kryetari.

Drejtori e pa veten hollë, më hollë se mani i zhveshur në palcë të dimrit. Ç'kishte e ku kishte, i shkundi në ligjëratën që mbajti sipas plankonceptit. «Argumenta» të tjera rezervë nuk kishte mbajtur për t'i përdorur për çdo eventualitet. Edhe plankonpekt rezervë nuk kishte përpiluar, kështu që s'dinte nga t'ia mbante më parë.

Gjithë vështrimet ishin ngulur mbi të, po nuk e humbi toruan.

«Ka vetëm një rrugëdalje, mendoi ai. Po nuk të shkoi kungulli nën ujë, bëj autokritikë, sepse kështu, zhyt e mbyt, mund të dalësh pa u mbytur... Dhe u ngrit e filloi të fliste pak si i tur-përuar:

Kéhintëndrejtë, shokë. Këtë jua them me «keqardhjetë thellë». Në jemi fajtorë, madje shumë fajtorë. Mbajmë përgjegjësi të rëndë përparrë popullitës Narkritikoni, shokë. Edhe populli të ha kritikojë pa mëshirë. Do të luftojmë me tërë forcë tonarët, njerëzit që do t'ju bënë çuditshëm. Nëpër këtë ingre është dot këtë barrë apo s'e ngrë? Populli do përfundon jo premtimë e justifikime. Qartë? Kështu, mblidhni mendjen edhe ti, edhe vartësit dinthaq përafazi komiteti.

— die Kette der Tugenden — ist ein Preis
für den Menschen, der sie aufweist.

Die Begründung der Rechtsverhältnisse zwischen dem Deutschen Kaiser und dem Deutschen Reich ist eine sehr wichtige Sache, die wir uns nicht entgehen lassen dürfen. Ich kann Ihnen nur sagen, dass es sich um eine sehr schwierige und komplexe Angelegenheit handelt, die viele verschiedene Faktoren einbezieht.

Die Ergebnisse der Untersuchungen sind in Tabelle 1 zusammengefasst.

«KA PLOT QEVERIA»

Dekurtimi i ministrave të Republikës së Shqipërisë
Drejtoria e Statutit, që ka qenë i vlefshëm
në vitin 1945, i cili është i përmendur si
Qëndronin, dhe soditnin pallatin, e madh pësëkatësh, që po ngrivej madhështor në një nga rrugët kryesore të qytetit.

Ishin katër veta. Në krye qëndronte drejtori, Pas tij zëvendësi dhe përbri dy inxhinierët.

Njëri nga inxhinierët pyeti:

— Si do t'ia bëjmë me vitrinat?

Drejtori sikur u zgjua nga gjumi,

— Me vitrinat? Aha, vitrinat!

Dhe ra në mendime. Në mendime ramë edhe ndihmësit e tij. Si drejtues të ndërmarrjes së ndërtimit ata duhej të dinin se ç' duhej bërë me vitrinat. Kur u ndërtua pallati, kati i poshtëm u bë dyqane dhe vetëkuptohet, çdo dyqan ka edhe vitrina. Dhe ata i ndërtuan ato, ashtu siç ishin parashikuar në projekt. Kaluan kështu ca muaj dhe ja, tani dikush u kishte sugjeruar:

— Madhështisë së këtij pallati keto vitrina nuk i shkojnë. A nuk do të qe më mirë ti ndertonit rishtazi?

Zëri i «masës» duhet dëgjuar — tha drejtori dhe aty përfatja lëshoi undherin: — Të përshten vitrinat dhe në vend të tyre të ndërtohen të reja!

— Po shpenzimet si do t'i justifikojmë? — pyeti njëri nga ata të bezdisurit e llogarisë, po drejtori nuk e la të fliste gjatë.

— Hë, a derëzi, se do t'ia gjejmë anën. U gjend bisht për dhelpërën dhe jo për shpenzime të tilla, se fundja, ne s'futim gjë në xhep.

Diskutimi u mbyll. Filluan punimet për ripërtëritjen e vitrinave. Drejtuesit soditnin zbatimin e urdhërit. Përbri tyre gjendej një godinë e pambuar, ku punimet ishin ndërprerë.

— C'do të bëhet më të? — pyeti përsëri zëvendësdrejtori.

— Nuk është në të njëjtin drejtim me pallatet e tjera, detyrohem i ta prishim — tha drejtori.

Kur arriten te godina madhështore e hotelit të ri, ata qëndruan. Përballë tyre punonin punëtorët, që po prishnin trotuarin dhe po çelnin një kanal. Punëtorët, të habitur për shkallmimin e trotuarit, e pyetën drejtorin, që posa u shkoi pranë:

— Shoku drejtor, punë më pa mend se kjo që na kanë urdhëruar të bëjmë sot, as që na ka zënë syri. S'ka një javë që u ndërtua ky trotuar dhe ja tani tek i vihet kazma...

Drejtori ndali çapin.

— Inxhinier! Vërejtja e punëtorëve është me vend.


— Jo, shoku drejtor — tha inxhinieri. — Këtu duhet bërë kanalizimi.

— Po, po, inxhinier! Në disa raste punojmë me këmbë e jo me kokë. Punëtorët e kanë shumë drejt. Kanalizimi mund të bëhej më parë, pastaj trotuari. E jo, sot ndërtoto, nesër prish. Janë shpenzime këto.

Inxhinieri u përgjegj qetë-qetë.

— Fundja, ç'peshë zënë shpenzime të tilla, në tërë buxhetin?

— Mendime të tilla janë të huaja. Ne duhet të kursejmë çdo lek të mundshëm — nënvízoj zë-vendësdrejtori. Pastaj qëndroi për t'i hedhur një



vështrim sheshit të madh që shتروھەج me pllaka
të reja.

— Ama, — tha zëvendësi — edhe këtu, në
këtë shesh, thela sa një pelë na kushtoi. Kursyem
njëqindmijë lekë për të mos e ngritur pallatin
barazi me lartësinë e rrugës dhe po shpenzojmë
pëseqindmijë lekë për të gërmuar e për të shtruar
sheshin. Kësaj i thonë: «Prish bucelë e bëj kënaçë».

— Paske hyrë në llogari të thella. Punët e
ndërtimit kështu e kanë — tha inxhinieri duke e
shikuar vëngër zëvendësdrejtorin për pakënaqësinë
që shfaqi. — Sot ndërtohet, nesër prishet, se lind
një mendim i ri, siç lindi për punën e vitrinave që
nuk i shkonin atij goxha pallati. Prandaj shteti
investon fonde të mëdha për ndërtimet. Ka plot
geveria.

— Shteti investon që të ndërtojmë me kokë
e jo me këmbë, sot të ndërtojmë, nesër të prishim.
Duhet t'i vëmë mirë gishtin kokës. Kush na lejon
të veprojmë kështu, inxhinier?

— Keni të drejtë, shoku drejtor, po atëhere
nuk i parashikuam dot.

— Lëri, lëri justifikimet! Për këto do të përgjigjemi edhe unë, edhe ti...

... qytetin tonë, që s'kam qetësi e njeut
qytetit tonë, që s'kam qetësi e njeut
«TË MJERËT QITËSA Ç'I GJETI,
VARUR DYFEKU U MBETI.»

Kjo bejte këndohet në qytetin tonë. Ne na e
tregoi vetë një amator i qitjes dhe ne geshim me
bejten, e cila nis kështu:

«Të mjerët qitësa ç'i gjeti, i jashtëm e nisi
varur dyfeku u mbeti.»

Qitësi amator, pasi recitoi vargjet, filloi të na
tregonte:

— Jemi kështu si na kanë lënë. Kemi katan-
disur si kaposhi një thelë. More, një thelë fundja
s'është keq, se duket nishani i kaposhit, po ne kemi
rënë edhe më poshtë se thela. (Ta bëra krahasimin
me thelën e kaposhit, se ata që duhet të merren
me këto punët e sportit këtu në bazë, rrinë gjithë
ditën ngrehur si kaponj duke u mburrur me ato
sportet e tjera dhe kujtojnë se, duke u dëgjuar ve-
tëm zëri i futbollit, apo edhe i ndonjë sporti tje-
tër, dëgjohet zëri i të gjitha sporteve të tjera. Nej-
se. Unë e kam hallin te qitja, se na ka mbetur
gishti në këmbëz e nuk e shkrehim dot. U dash-
kan një pendë buaj që të lëvizin nga vendi drej-

tuesit e fizkulturës e të kërkojnë të na vihet në dispozicion poligoni i qitjes, i cili qëndron i mbyllur.

Ne, që thua ti, të thajmë. Shpesh, në kampionatet kombëtarë kemi zënë vende nderi, po kush pyet se? Inspektorit të fizkulturës të rrethit tonë aty e ca kohë më parë iu lutëm: «Amani, ore burrë, mbetëm pa u stërvitur! Do të vijë dita e kampionatit dhe do të turpërohem!». Po ai na tha:

— Hëni ju, hëni, se do të rregullohen të gjitha. Mos e zgjatni tërkuzë, se nuk do të lidhni dengje. Edhe gratë që ngarkoheshin me barrë në shpinë nuk ngarkohen më, kështu që tërkuza juaj s'ka përsë na duhet. Kështu e kanë këto punë. Të mirat bëhen avash-avash. Ja, sa të mbarojë kampionati kombëtar i notit dhe me punën e dyfekteve do të merremi.

Ne prisnim. Kampionati kombëtar i notit filloj dhe mbaroi. Ne përsëri kërkuam:

— Hë, do të fillojmë?


Ai kësaj radhe na buzëqeshi.

— Do të fillojmë, ore, si nuk do të fillojmë. Do të tundet qyteti nga dyfeket, po dale edhe ca, të përfundojmë takimin ndërkombëtar të notit.

Pastaj, ama, për qitje? Po ne, shqiptarët, gjysh katragjyshi dyfeket me gjalmë i kemi mbajtur dhe kemi shpuar gjysmën e lekut nga një vreten larg. Prisni, prisni, se i duruari, i fituar del.

Dhe ne filluam të prisnim me durim, po gjer tanë nuk po shohim asgjë veç fjalëve të mira. Kur kërkojmë të stërvitemi, ai na mban nga një ligjëratë: «Shqiptari, kurrë nuk e ka hequr gishtin nga këmbëza. Këtë e thotë historia dhe ju nuk duhet të dilni kundër historisë, prandaj, o burra, armët në krah dhe marsh!»

Kështu, ne marrim yryshin për në kampionat pa bërë asnje ditë praktikë, se jemi trashëgimtarë të paraardhësve tanë ilirë, që kanë ngrënë edhe hekurin me dhëmbë. Ne shkojmë në kampionat me shpresë se, kur të kthehem që andej, nuk do të na harrojë më.



JENI Shpresat toni shkuan kot. Ne na harroi përsëri. Siç duket ai përsëri pret që të vijë dita e kampionatit kombëtar dhe të na mbledhë sërisht mi kokë më kokë e të na thotë: «Ku jeni, o qitesa të shkëll qyerr, u që këputni edhe lekun me një të shtënë? O burra, drejt e në kampionat! Shtimi! Bëjeni poligonin tym e flakë dhe le ta marrin vesh të gjithë se çfarë qitesash stërviten në rrethin tonë. Pastaj, se mos do të fitojnë të gjithë ata që do të marrin pjesë në kampionat?! E rëndësishme është që të marrësh pjesë...»

— Në kampionat shkohet për të qitur e jo përtu stërvitur, o lum inspektori — i thamë ne.



MOS NA TRAZONI ÇANAKUN!

Bisedën e kishim shtruar si çobanij gunëndhë fjalët i rrëmonim siç rrëmojnë i plakatë zjarrin pér t'i dhënë flakës një përcik gjuhë e pér ta qmbushur vatrën gjithë shpuzë.

Haxhiu ishte ulur në qoshen e majtë, ku kishte shtruar një lëkurë dashi, që në kohë të tij do të ketë pasur mish të majmë e do ta ketë bërë janinë me lyrë gjer në grykë të pocës. Herë pas here, ai, duke kapsallitur sytë, hidhët vështrimin sa nge mjeku, që kishte zënë vend në qoshen e djathtë, si mik i parë që ishte dhe herë këtej nga unë, që, si i fshatit, rrija shkujdesur pas tij, mbështetur në ca jastëqe mbushur me lecka. Me cepin e buzës, ai kishte kapur nja dy-tri fije mustaqe të zverdhura si qelibari dhë i ndukte ngadalë dükë blujtur dicë në mendje.

— Na janë rritur të ardhurat, — thoshte Haxhiu — na janë rritur mirë. Kemi ndryshuar shumë e nuk po e njohim veten.

— Veç shkuleni me zor nga disa zakone të vjetra — u hodh mjeku.

Haxhiu i nguli vështrimin sikur të donte ta

pyeste: «Nuk po të kuptoj, or mik, se ku kërkon të dalësh».

Mjeku e kuptoi dhe e ngau më tej mendimin:

— Ke nga të gjitha. Shtëpi të re, orendi të reja, mobilje të reja, po pse vazhdoni të hani në një çanak?

Unë që nuk rrija dot pa i trazuar mendimet, hodha një grep për të ngecur ku të ngecate.

— Vërtet, o Haxhi. Pjata keni me bollëk. Përse nuk i përdorni?

Haxhiu ma priti flakë për flakë si gjëhtari lepjurit që i del në udhë.

— Pjatat i kemi për miqtë.

Dhe, si i lëdhë zjarrit një krah dru, që sapo i pruri një nga çunat, i bëri udhë mendimit.

— Urdhëroni! Erdhët ju sonte? Duheni pritur si ma do nderi. Ndryshe ju do të ikni e do të thonë: «Ama edhe ai Haxhi Mestani! I rroftë pasja! Të ardhura nga kooperativa ka me bollëk, po pesë pjata nuk i kishte blerë».

— Dhe pastaj? — e shtyva bisedën unë.

— Pastaj mua do më mbajë në gojë i gjithë fshati e konaku im nuk është turpëruar për gjëra më të mëdha e jo për pesë copë pjata, fjala vjen.

— Këtu ta kam edhe unë — hyri në bisedë mjeku. — Ti bën mirë që miqve u nxjerr të hanë në pjata veç e veç, por ato nuk duhet të mbeten vëtëm stoli për miqtë, por duhet të përdoren nga të gjithë pjesëtarët e familjes.

— Lepe, lepe? — Haxhiu u tendos pak përpara e bebëzat e syve iu zvogëluan nga yshtja e fjalës.

— Si the zotrote?

— Nuk duhet të hani në një çanak të gjithë

kur keni pjata me bollék. Të ngrënët më njëllçanak éshtë antihigjienik — shtoi mjekut.

— U u u... tē keqen e gojës, o doktor, po, shyqyr, gjer më sot, nuk na ka gjetur ndonjë e keqe — foli plaka e Haxhiut që kishte hyrë në odë dhe kishte dëgjuar fjalët e fundit tē mjekut. — Çanaku plot, shtëpia plot dhe barku plot, o doktor, tē paçim me nder! Ymrin nuk na e merr çanaku, tē keqen nëna. Çanaku ta shton ymrin dhe, duke iu drejtuar tē shoqit, plaka shtoi. — Hë, o burrë, folë edhe ti një fjalë.

Haxhiu, që sapo i kishte hedhur një brez rakisë, u dha një tē lëpirë mustaqeve, u shkoi edhë një herë samarin e dorës dhe i mbajti krahun së shoqes.

— Ka hak plaka, o shoku doktor. Kemi dalë tē gjithë nga një bark e çanaku mbledh gjithë barkun në bark tē tij. — E ç'të keqe ka këtu?

— Si, ore, s'paska tē keqe? Të hanë tē gjithë në një çanak, tē pinë në një gotë, éshtë papastërti — shtoi mjeku.

— Pse tē ndahemi, kur kemi shyqyr me bollék? — tha Haxhiu.

— Vëllazëria nuk duket në çanak — e ngacmova unë.

Ai u kthye si ta kishte pickuar grerëza dhe tërë duf shfryu ndaj meje:

— Ti mos folë përcart e sikur nuk tē ka rënë koka në këtë baltë fshati. Çanaku na mbledh, na mban bashkë. Jemi vëllazëri, ore, e jo hasmëri.

Fjala u trash. Mendimet u trazuau. Gjuhët u zgjidhën. U prish edhe sëra. Fliste plaka përpara Haxhiut e ky i hidhte majë fjalës së sësajt e fjala e

ardhür fryhej, dhe derdhej si lumenjtë kur dalin nga shtrati.

— Pa! pa pa... — ajo shtrëngonte meçen përpara gojës, se nuk e përbante dot zemërimin — nuk na the gjë! Veç e veç hanë vetëm ata që nuk merrin vesh me njëri-tjetrin...

— Ka hak, ka hak plaka — e mbështeste Haxhiu dhe i kthehej plakës: — Hé, më të lumtë goja! Tërë jetën xhevahir ke nxjerrë nga goja.

Plaka krekozej, Haxhiu mbronte mendimin e vet, ndërsa mjeku nuk e linte bisedën të ftohej.

— More Haxhi, — ngulte këmbë mjeku — sikur je me të renë dhe duhet ta kuptosh se të ngrënët në një çanak është antihigjenik. Pa mendo njëherë. Lugët nga goja i vë në gjellë e kështu bashkë me lugët venë aty edhe jargët tonë. Merre me mend se si bëhet aty. Jargë e gjellë bashkë. Kështu hani jargët e njëri-tjetrit.

Haxhiu ia dha gazit. Plaka mbështetej fort pas meçes së vet.

— Hi hi hi... jargët, thotë — dhe qeshte mbeturazi. — Po ç'punë kanë jargët në çanak, o doktor? Jargët i kapërcejjmë në gurmaz, o doktor!

— Ashtu vërtet, ashtu. Jargët i shtyjmë në gurmaz — tha Haxhiu.

— E megjithatë, — ia preva unë fillin e ligjëratës — ti nuk ke të drejtë. Mjeku ta tha fare shkoqur. Edhe ti e kupton fare shkoqur, po nuk shkëputesh dot nga mënyra e vjetër e jetesës.

Haxhiu u bë serioz.

— Dëgjo, — më tha dhe e mori fjalën më shtruar — kjo puna e çanakut nuk duhet ngatërruar me jargët. Çanaku, që ta marrësh vesh zotote, është si puna e kolektivit. A duhet të jemi të

baškuár? Duhet. A jemi tē bashkuar? Jemi. Hë. prá, edhe çanaku na mbledh tē gjithë e nuk na ndan kashtë e keqe si Kashta e Kumtrit. Ja kështu.

— Veç mós ngatérro kashtën me kokrrën — ia priti mjeku. — Edhe bleta bashkë nē një zgjua është, por çdo mizë ha vec.

— Eh, ha, nuk them, vec ha, vec. Po pse tē hamë vec, more, jahu?

— Që tē na bëhen një barrë enë pér tē larë? — i erdhi nē ndihmë plaka, që e kuptoi se i shoqi u lëkund fort nga mendimet që mbronte, po pér-séri mjeku errahu hekurin sa qe i skuqur.

— Ujët nuk ju mungon — tha mjeku.

— Vërtet nuk na mungon, por ama me krahë merret i bekuari — iu përgjegj Haxhiu.

— Nuk jeni qarë pér krahë pune ju, jo — i thashë.

Plaka e Haxhiut më vështroi si me qortim.

— Ah, more çuni i Stavrit! — m'u drejtua. — Le ky, doktori, se kështu ia do zanati, po na u bëre rrodhe edhe ti, që tē kemi tē fshatit.

Më nē fund Haxhiu u «dorëzua pa kushte». Plaka deshi t'i shtonte «marrëveshjes» ndonjë «klauzolë», por i shoqi kësaj radhe nuk u pajtua me tē.

— Lëre, plakë, lëre, — tha — se çanaku, çanak tē bën.

— Mirë — ngulte këmbë plaka nē tē sajën. — Hajde de pér tē mëdhenjtë, se na u ardhka ndoht nga jargët, po çiliminjtë duhet tē hanë bashkë e nuk duhet t'ua futim ndarjen nē bark sa s'u është pjekur koska.

— Si çiliminjtë, si tē mëdhenjtë, njëlloj është. Shëndeti është shëndet e Partia nuk e ka kot që

lodhet me kokët tona — i ra drejt Haxhiu dhe, duke u kthyer nga ne; shtoi: — Të paçim, o shoku doktor! Edhe ty, o çuni i Stavrit, të rruat çuni e u gëzofsh me ndonjë çupë, se janë të dashura të flamosurat! Le që nà duhen edhe për t'i marrë nuse për djemtë. Ju lumshin këmbët që na erdhët sonte e kështu më ardhshi ngahera! E, në më pafshi më që të më hanë edhe fëmijët në një çanak, më kritikoni para tërë fshatit.

Dhe e rrëkëlleu gotën, ndërsa plaka, duke shpuar me mashën urët e zjarrit, përshpëriste:

— Epo... për çiliminjtë s'bëhej qameti të shkretën, po punë doktori, thuaj.

USTA THANASI

Usta Thanasi po plakej në zanat dhe në ndërmarrje. Tërë jetën ai qe marrë me hekura dhe me duart e tij e kishte ngritur atë ofiçinën e vogël atje, në një cep të oborrit të ndërmarrjes, ku si zakonisht punëtorët hidhnin mbeturinat.

Pjesën më të madhe të ditës ai e kalonte atje, duke riparuar pjesë të ndryshme të maqinerive apo duke pastruar me kujdes ndonjë pjesë të vjetër këmbimi për t'ia zgjatur sa më shumë jetën. Aty midis hekurave ai ndjente kënaqësinë e madhe të punës së tij shumëvjeçare.

Por usta Thanasi nuk e honepte dot muhabetin me gratë dhe kjo ishte për të një bela e madhe, sepse në ndërmarrje pjesa më e madhe e punëtorëve ishin gra. Megjithëse ai përpinqej të mos e jepte veten, përsëri kishte raste kur ato e dogëndisnin shumë e ai nuk përmbahej.

— Po shkoni, moj, e këputni qafën, — ulërinte ai — shkoni, moj, e ia paraqitni kërkesat përgjegjësit të repartit e ai le të vijë tek unë. Ç'më vini këtu plot llafe e muhabete?

Po, kur ndodhë që i vinte ndonjë përgjegjëse reparti — sepse në ndërmarrje kishte më shumë

të tilla — ai e përtypste fjalën, e mbllaçiste sa andej-këtej dhe pastaj ia kthente sandraç:

— Ka ustallarë në repartin tënd? Ka. Atëhere ç'më vjen ti? Le të vijë ndonjë nga ata.

Qëndrimi i tij ndaj grave qe bërë shkak që të tjerët të thoshin se usta Thanasi i urrente gratë, por kjo nuk e shqetësonë dhe aq shumë atë.

— Le të thonë c'të duan — thoshte ai. — Të ngeshmit merren me llafe. Unë i urrej gratë? Gje-pura! Unë e mbaj plakën në pëllëmbën e dorës. Edhe nusen e djalit. në pëllëmbën e dorës e mbaj. Le të thonë c'të duan. Fjalë pa themel. Nga njëri vesh më hyjnë e nga tjetri më dalin.

Po fundja, të gjitha këto nuk shqetësonin njëri, sepse zemrën nuk e kishte të keqe. Vërtet thërriste ca, hera-herës edhe cirrej fort, po asnjeri nuk nxirrte duarbosh nga oficina. Cilitdo i mbaronte punë dhe i jepte një vârg këshillash për ruajtjen e pjesëve të këmbimit.

— Kujdes, djalë! Janë vegla këto. Janë fituar me djersën e ballit, janë flori, flori po të them. Duhet ruajtur vegla, i duhet zgjatur jeta, hë, djalë, dhe jo hë e më të reja. Të vjetrat, të vjetrat, ato i shikoni mirë e mës i merrni varda-varda, hë, bir.

Kështu punonte e plakej usta Thanasi, gjersa një ditë, nuk dihet se si e qysh u hap një fjalë e u tha se usta Thanasit do t'i çonin një nxënës, sepse ai po i afrohej pensionit, prandaj duhej t'ia linte dikujt zanatin.

Kur e thirrën në drejtori dhe i thanë se kishin menduar t'i dërgonin një vajzë si nxënëse, thellë në ndërgjegje e theri diçka. Ai tha me vete:

«Këta nuk e vlerësojnë punën e mekanikut.

Kjo' nuk éshtë punë pér femra, por pér burra, bille pér burra që e mbajnë mendjen top pér t'u bërë mekanikë. Femrat e kanë mendjen te fustanet, te këpucët, te sandalet, te trikot, e ku di unë...»

Po ata tē drejtorisë i thanë se mosbesimi tek aftësitë e femrës éshtë një koncept konservator. Usta Thanasi, pa e zgjatur, u tha:

— Doni tē sillni një vajzë si nxënëse? Po sllenë, more. Silleni. Unë nuk do tē kursehem. Q'di vetë, asaj do tia jap. Do ta mësoj unë e do ta bëj si veten. Vëtëm vullnet tē ketë pér tē mësuar.

Usta Thanasi doli vak si i dëshpëruar nga drejtoria, sepse do tē deshte t'i çonin një djale e jo vajzë.

Të nesërmen në derë tē oficinës u duk një vajzë e re.

— Erdha unë, usta Thanas — i tha ajo. — Më dërguan.

Ai me një vështrim tē shpejtë e peshoi atë që te koka e gjer te këmbët.

— Erdhe ti, ë? — pyeti.

— Erdha — u përgjegj ajo në çast.

Ai tundi kokën.

— E shoh, e shoh — i tha dhe, si tē fliste me veten, shtoi! — Erdhe, ë? E, meqë erdhe... mirë se më erdhe, moj çupëzë! — Dhe u futën së bashku në oficinë. Ajo ditë kaloi pa u ndjerë.

Çupëza — kështu filloi ta thërriste usta Thanasi nxënësen e re — e ndjente veten tē gjëzuar.

Të nesërmen në mëngjez, kur erdhi usta Thanasi, ajo, e veshur me kominoshe, po e priste të dera e oficinës.

«Çupëza, mendoi ai, e dashka, e dashka zana-

tin, sic duket». Po çupëzës nuk ia shprehu këtë mendim.

Kur usta Thanasit pa çupëzën të veshur me kominoshe, me flokë të mbështjellë prapa dhe aq më tepër kur pa se ajo po punonte pa përtesë dhe po zinte çdo hekur, vegël pune a detal me dashuri, filloj të ndërronte mendimin që kishte përfunduar. Por ama një mendim i erdhë përsëri.

«Dale, dale, se shpejt është. Disa e fillojnë punën me vrull, pastaj u shuhet vullneti si flakë kashte, sepse u vjen ndoht nga vajrat.

Punë e rëndë kjo e mekanikut përfunduar, por ç’ti bësh? E prunë tanë. Vetë deshi, po... do ta ndihmoj, ja, ashtu, avash-avash, sa të mësohet».

Ditët po kalonin. Çupëza po mësohej edhe me zanatin, edhe me zakonet e usta Thanasit. Edhe usta Thasasit po i lëkundeshin bindjet e tij. Një ditë, ndërsa po merrej me riparimin e një detali, atë e thirrën urgjent në drejtori. Çupëza mbeti vetëm me pjesën e këmbimit në dorë.

— Prit, se erdha unë — i tha usta Thasasi. — Ulu e lexo gazetën. Mëso,

Dhe iku.

Cupëza iu shtrua punës. Pas një ore, kur erdhë usta Thasasi, ajo e kishte përfunduar riparimin.

— Vetë e bëre? — e pyeti dhe po e rrotullonte detalin nëpër duar.

— Vetë — iu përgjegj ajo e sytë i lëshonin shkëndija gëzimi.

Usta Thasasi vazhdonte të rrotullonte nëpër duar detalin dhe ta vështronë atë mbarë e prapë. Në kokë bluante mendimin.

— Demek, ma paske marrë zanatin mirë, ë? Të lumtë, të lumtë, bija ime! Unë në fillim nuk

kisha besim, as te ti, dhe as te një grua, se ky
është zanat i vështirë për ta mësuar dhe i rëndë
për ta përdorur. Por ja që ti, bija ime, ma mbushe
mendjen top se e kam pasur gabim.

Dhe i hodhi dorën mbi leshra. Pastaj që të dy,
ustai e nxënësja bashkë, nisën nga riparimet e de-
taleve të tjera që kërkoheshin me ngut.

— Nëse është e mundur, pofta më shumë
dhe më shumë. — Dëgjoi që e mësuar, që e tregim
që është e mundur, që është e mundur, që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Gjithashtu

Këshilla mësuar. A mund, mëgjithëse
nëpërmjet gjithë sëmundjeve, që
është dëgjimi i kësaj qëndrimit
që është e mundur. Si e mundur, që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.

— Nëse është e mundur, pofta më shumë.
A mund, mëgjithëse nuk mundet që e mundur, që e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.

— Nëse — nëse — nëse — nëse — nëse —
zot, që është e mundur, që është e mundur, që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.
Dëgjoi që e mundur. Si t'i tregim që është e mundur.

«...SI THEM UNË»

Në sektor komandon përgjegjësi. Ai ka mendimet e tij, vepron sipas mënyrës së tij dhe ka originalitetin e tij që e shpreh atje ku ia lyp nevoja. Si i tillë ai ka në dorë edhe arrën, edhe gurin».

Kështu mendonte Avniu, përgjegjësi i sektorit të parë, tek qëndronte atje pas tryezës, sipër së cilës qëndronin dosjet e ngarkuara me plane, grafikë, raporte e diskutime të parapregatitura për t'i shprehur atje ku t'ia lypte nevoja, duke u përpjekur të jepte që andej urdhëra të prerë, që filionin e mbaronin me fraza të prera: «Kështu them unë», «kështu mendoj unë», «kështu si them unë», «kështu të bëhet, ...».

Avniut i qe mbushur mendja se në fshat vetëm ai ishte i aftë për të menduar, për të drejtuar dhe për të dhënë urdhëra, sepse vetëm ai ishte më i dituri, prandaj urdhërat e tij nuk duhej të diskutoheshin.

Kooperativistët i thoshin njëri-tjetrit: — «Para përgjegjësit tonë dhe pas mushkës së tij, mos qëndro, se pëson gjëmën».

Avniu gjithnjë thoshte: «Ne nuk jemi si këm-

bët e dhisë», prandaj, kur reagonte ndonjë kooperativist «i pabindur», ia mbyllte kapitullin e diskutimit me tri fjalë: «E di përgjegjësi...»

— Çudi, — thoshin kooperativistët — sa i sjellshëm ishte para se ta bënim përgjegjës! Tani s'fliitet me të. Lëre më po i zure në gojë kulturën, pre-gatitjet pér festivalin folkloristik të rrëthit, apo ndërtimin e shtëpisë së kulturës e të çerdhes, të zë sherri me të.

— Ne kemi plan prodhimi e rendimenti pér drithërat, pér patatet, pér perimet, pér frutat, por jo pér kulturën — thoshte përgjegjësi i sektorit.

— Shoku përgjegjës, — i thoshin të rintjtë e të rejat — ne jemi dakord dhe po luftojmë pér tejkalimin e planit të rendimentit dhe të prodhimit të të gjitha kulturave dhe të asortimenteve, por edhe pér kulturën kemi plan. Njerëzit, ashtu siç kanë nevojë të hanë, kanë nevojë edhe pér kulturë.

— Por ai as që ndalej pér të arësyetuar. Ua priste shkurt:

— Bukë, bukë e jo këngë e valle, morët vesh? Pér të prodhuar bukën, duhet punë e jo këngë e valle. Kur t'i mbledhim prodhimet, atëhere mund të merremi me punët e kulturës. Hajde, shkon, shtrojuni punës dhe mos t'ju shoh të më vini më pér kësi lloj pehlivanllëqesh. — Kështu u tha ai një ditë kur mori vesh që grapi i këngëve dhe i valleve të shkollës, kishte pregetitur një program pér brigadat e sektorit ku drejtonte ai.

— Po pér pregetitjet pér festivalin folkloristik të rrëthit si t'ia bëjmë, shoku përgjegjës? — i kishin thënë të rintjtë e të rejat.

— As mos më zini në gojë çështje të tillë. Unë nuk merrem as me këngë, as me valle. Nuk di të

këndoja, as të kércej. 'Unë jام përgjegjës për punë e jo për këngë e valle. Morët vesh? — u kishte thënë ai.

«Përgjegjësi ynë nuk e kupton nevojën e kulturës, i thanë të rinjtë e të rejat njëri-tjetrit. Megjithatë ne nuk do të rrimë duarkryq. Të pregatitëm qdo natë për festivalin».

— C'është kjo turne, more? — thërriste përgjegjësi. — C'janë këto peripecira kështu? Duket bukë, bukë e jo festivale e turnera. Gjëra boshe janë të gjitha, gjëra që nuk të japin bukë. Hajde, mjaft u drodhët. Morët pjesë në festival, fituat edhe çmim, tani ç'doni? Shtrojuni punës, se punatë jep bukë e jo këngët e vallet nëpër turnera e ku di unë. Në turnera le të harakopen të tjerët. Ju në punë. Hajde, marsh! Kemi thënë ta rritim rendimentin e drithit? Kemi thënë. Po e arritëm këtë objektiv, kemi bërë edhe këngën, edhe vallen, edhe kulturën, morët vesh? Morëm, thoni.

Por rinia, madje edhe të moshuarit, nuk ishin të një mendjejë me përgjegjësin.

— O shoku Avni! Sikur nuk e ke mirë naduket. Buka, bukë, po edhe kultura, kulturë. Ka kaq kohë që kanë filluar punimet për ndërtimin e shtëpisë së kulturës dhe nuk po mbarojnë. Punë është kjo?

— Juve ju është bërë mendja kulturë. Po akoma s'e keni kuptuar se njerëzit hanë bukë e jo kulturë, more? — u përgjegjej ai prerazi e plot zemërim.

— Edhe çerdhja e fëmijëve mbeti përgjysmë, shoku përgjegjës.

— Bukë, bukë — përgjegjej Avniu. — Bukë na duhet e jo mure.

— Po fëmijët e vegjël ku t'i lëmë, more shoku përgjegjës? — i thoshin gratë.

— Atje ku na lanë nënënat tonë ne — përgjegjë ai.

Dhe një ditë fshati u zgjua duke gumëzhitur. Në sheshin kryesor përpara kryesisë kishin vendsur një fletërrufe.

«Përgjegjësi i sektorit të parë, shoku Avni, nuk e do kulturën. Ai nuk mendon fare për nënënat e fëmijët...» nënëvizonin autorët e fletërrufesë.

Kjo e tërboi Avninë dhe në vend të përgjegjes së kritikës, vuri një shënim:

«Me fletërrufenë jam dakord, me përbajtjen jo. Jemi në kohë pune e s'kemi kohë për debate. Kështu u përgjegj ai; duke menduar se kështu do ta kalonte lumin pa u lagur.

Mirëpo dushi që i bënë në mblidhje të sektorit e bëri Avninë që të ekte përtokë dhe gërshtërit e tij. të prisnin jo vetëm në një krah, por në të gjithë krahët.

Një ditë kur po kthehej nga fusha miq qylyken në sup shoku që ekte përkrah tij i tha:

— Kthehemini njëherë nga shtëpia e kulturës, se dua të marr një libër.

— Edhe unë — u përgjegj Avniu.

— Po ti... — tjetri buzëqëshi dhë i rama bëtryl — ti sikur...

Avni i dha shokut një pickamë të fortë dhe të dy, krah për krah kapërcyën derën e bibliotekës së shtëpisë së re të kulturës.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Ismet Lamçja i dyqanit	3
Kur këndoijnë gjelat!	9
Modulari B.	13
Fejesë pa llogari	22
«Heroi» i sektorit tonë	27
Të fala nga dhitë	31
Dialog me xherahun	36
Babai kërkon muse	41
Kur i varen ujkut mëlcitë në qafë	46
Miu i magazinës	51
Një mbledhje e jashtëzakonshme	56
Kujdes, se të sheh roja!	60
Kur kënaqesh me një autokritikë	64
«Ka plot qeveria».	69
«Të mjerët qitësa ç'i gjeti varur dyfeku u mbeti!...» ..	73
Mos na trazoni çanakun!	77
Usta Thanasi	83
«...Si them umë».	88